

mbikëqyrësi unë si menaxher projekti bashkë me inxhinierë të dikasterit që e drejtoj, sepse Bugari nuk ka përgatitje profesionale për mbikëqyrje në aspektin e cilësisë së punimeve”, ka deklaruar Fetoshi.

Nga ana tjetër, Bugari, si organ mbikëqyrës i projektit, ndihet i

“Riparim rruges do të bëhet edhe në 2 pika në fshatin Fortesë, dhe 3 sosh në Sopniq”, ka bërë të ditur Fetoshi. Për arnimin e rrugëve nga buxheti i Komunës për sivjet janë 120 mijë euro.

© KOHA Ditore

YAGR: Ekzekutivi i Lipjanit brenda 3 muajsh me 8 dështime

Arian Duriqi

LIPJAN, 25 PRILL - OJQ YAGR ka publikuar, të premten, rezultatet e hulumtimit të opinionit publik për qeverisjen e 100 ditëshe të kryetarit të Lipjanit, Imri Ahmeti. Ndërsa është thënë në analizë se për pak më shumë se 3 muaj qeverisje Ekzekutivi lipjanas ka pasur tetë dështime. Në raport janë përmbledhur edhe sukseset e kësaj periudhe, edhe opinionet e pjesëtarëve të opozitës.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAGR, ka deklaruar me këtë rast se gjatë hulumtimit midis tetë dështimeve janë gjetur shkelje serioze të ligjshmërisë, punësime familjarësh, punësime aktivistësh të LDK-së dhe largim punëtorësh nga puna.

“Si dështime kryesore të 100-ditëshit janë shkelja e ligjshmërisë për nënkryetarin për komunitete, largimet e punëtorëve nga puna pa kriter nga shkolla bujqësore në Lipjan, e menaxhimi i ujërave e zeza. Ndërkohë që, nuk ka asnjë projekt të filluar që nga marrja e mandatit, derisa edhe me këtë qeverisje ka vazhduar mënyra a vjetër e rekrutimit të militantëve partiakë”, ka thënë Krasniqi, ndërsa ka shtuar:

“Si dështim është evidentuar edhe injorimi dhe mospërgjigjja e takimeve me palë, mungesa e transparencës dhe politizimi i drejtorëve të shkollave, si edhe punësimi i familjarëve”.

Por, cilat ishin sukseset e kësaj periudhe të kryetarit Ahmeti. Krasniqi ka

thënë me këtë rast se pyetjeve për dështime e suksese i janë përgjigjur 300 qytetarë të cilët kanë dhënë mendime të ndryshme.

“Si sukses është evidentuar zgjidhja e problemit me ujësjellësin në Magurë, ndërsa e arritur ishte edhe heqja e taksave komunale për bizneset. Kjo qeverisje, ndërkaq, ka bërë edhe zgjidhje të disa parregullsive edhe shkeljeve ligjore të cilat janë bërë nga ish-kryetari”, ka thënë Krasniqi.

Ndërkohë që, në hulumtim janë evidentuar edhe mendimet e rivalëve politikë. YAGR shkruan se për pyetjen drejtuar opozitës (dy partive politike PDK dhe LVV) ka marrë përgjigje vetëm nga PDK-ja, ndërsa kjo parti është përgjigjur vetëm në mospërgjigjeset e Ekzekutivit lipjanas. “Shkelja ligjore në emërimin e nënkryetarit për komunitete, përbërjen e komiteteve duke mos përfshirë forcat më të mëdha politike (sipas vendeve në Kuvend) dhe mostransparenca ndaj qytetarëve, si dhe shoqërive civile kanë qenë thumb kritike nga PDK-ja”, ka thënë Krasniqi.

Ky raport i OJQ-së YAGR vjen, ndërkaq, vetëm pesë ditë para mbledhjes së radhës së KK-së në të cilën do të shpaloset raporti i punës së zyrës së kryetarit Ahmeti dhe drejtorive komunale për periudhën janar – mars 2014. Ndërkohë që, deri në kohën e raportimit nuk ka pasur ndonjë reagim nga autoritetet komunale të Lipjanit lidhur me këtë publikim.

© KOHA Ditore